



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 436/13 prot.

Datë 01.04.2026

V E N D I M

Nr. 452/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.04.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 361/2026, datë 09.03.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-74975-02-02-2026, me objekt: “Loti 5 Kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma”, me fond limit 47,775,000.00 Lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 05-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “TerraMed” SHPK me NIPT M41422073G dhe adresë Rruga “Sulhaxhi”, Muçaj, Zona kadastrale 2726, Nr. Pasurie 137/52, Vorë, Tiranë.

Operatori ekonomik “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK me NIPT J61827062E dhe adresë Blv: “Zhan D'ark”, Pallati 53, Ap 6b, Tiranë

Operatori ekonomik “MEDFAU” SHPK me NIPT J93610823R dhe adresë Rruga “4 Dëshmorët”, Nr. 195, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, me adresë Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 09.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 361/2026, ku vendosi:
[...]

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “TerraMed” SHPK për procedurën e prokurimi “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-74975-02-02-2026, me objekt: “Loti 5 Kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma”, me fond limit 47,775,000.00 Lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 05-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatorit ekonomik “Medfau” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
4. Të mos pranojë ankesën me nr. 436 prot., datë 11.02.2026 të operatorit ekonomik “TerraMed” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
5. Të pranojë pjesërisht ankesën me nr. 436/1 prot., datë 11.02.2026 të operatorit ekonomik “TerraMed” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
6. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Medfau” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
7. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
8. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe Komisionit të Prokurimit Publik.
9. Autoriteti kontraktor, brenda 5 (pesë) ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
10. Ngarkohet zyra e financës, që të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “TerraMed” SHPK, operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK, operatori ekonomik “Medfau” SHPK.
11. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
12. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën me nr. 1539 prot., datë 30.03.2026 me lëndë “Njoftim mbi zbatimin e vendimit”, protokolluar me tonën me nr. 436/10 prot., datë 31.03.2026 autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara njofton se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 361//2026, datë 09.03.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-74975-02-02-2026, me objekt: “Loti 5 Kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma”, me fond limit 47,775,000.00 Lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 05-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a. Bashkëlidhur autoriteti kontraktor ka dorëzuar Njoftimin për ndryshimin e dokumentave të tenderit me nr. 1458/10 prot., datë 30.03.2026.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën me nr. 1539 prot., datë 30.03.2026 me lëndë “Njoftim mbi zbatimin e vendimit”, protokolluar me tonën me nr. 436/10 prot., datë 31.03.2026 autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara njofton se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 361/2026, datë 09.03.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-74975-02-02-2026, me objekt: “Loti 5 Kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma”, me fond limit 47,775,000.00 Lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 05-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.. Bashkëlidhur autoriteti kontraktor ka dorëzuar Njoftimin për ndryshimin e dokumentave të tenderit me nr. 1458/10 prot., datë 30.03.2026.

II.2. Referuar shkresës me nr. 1539 prot., datë 30.03.2026, si dhe nga verifikimi i kryer në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit në përputhje me vendimin me nr. 361/2026, datë 09.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, në mënyrë që të bëhet e njohur për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar.

II.3.Sa më sipër arsyetuar autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 361/2026, datë 09.03.2026.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-74975-02-02-2026, me objekt: “Loti 5 Kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma”, me fond limit 47,775,000.00 Lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 05-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

